



“TRING TV” SH.A. Dega në Kosovë
Pronar: Tring TV SH.A.
OSHP “TRING WORLD”
Rr. Luan Haradinaj nr. 19/3
Prishtinë

Vendimi LIC/OSHP-KKPM: 2013/04
Ref: 1301/195/KPM/ni

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “TRING WORLD” - Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distriimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04) ka hyrë në fuqi më 06.07.2007, ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore të cilat do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 30 qershor 2011 kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore “TRING WORLD” ka paraqitur në KPM aplikacionin për Licencë të KPM-së.

Arsyvetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjektet transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së “TRING WORLD” në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullës CIMC 2007/04 ofruesi i shërbimeve programore “TRING WORLD” nuk ka paraqitur të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së.
6. Komisioni i KPM-së vlerëson se kandidati “TRING WORLD” nuk ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit, të cilat mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.


7. Komisioni i KPM-së vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "TRING WORLD" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.


Vendim

8. Komisioni i KPM-së konkludon se "TRING WORLD" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe nuk ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
9. Komisioni i KPM-së vendosë që, ofruesit të shërbimeve programore "TRING WORLD", me seli në Prishtinë, t'i refuzoj kërkesën për licencën e KPM-së për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
10. Kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore, "TRING WORLD", ka të drejtë që në të ardhmen të aplikoj përsëri për licencë të Ofruesit të Shërbimeve Programore, mirpo duhet të dorëzojë aplikacion të ri dhe të kompletuar në zyrën e KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon KPM.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media.



28.12.2012
datë